

E DREJTA PËR INFORMIM


Zhvillohet mbledhja e parë për vitin 2025 e Komitetit Ekzekutiv të ICIC



Në muajin mars 2025, u zhvillua takimi i parë për vitin 2025 i Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC). Kjo mbledhje shënoi dhe organizimin e parë të kryesuar nga Zyra e Komisionerit në rolin e saj si President dhe Sekretariat i kësaj organizate.

I zhvilluar online, ky takim u drejtua nga Komisioneri z. Besnik Dervishi dhe mbledhi përfaqësues të autoriteteve për të drejtën e informimit të Gjermanisë, Australisë, Afrikës së Jugut, Bermudës dhe Sierra Leones. Në hapje të punimeve, Komisioneri Dervishi mbajti një fjalë përshëndetëse, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në forcimin e transparencës dhe të drejtës për informim. Pjesë e rendit të ditës ishte miratimi i minutave të takimit të mëparshëm të Komitetit Ekzekutiv, prezantimi nga autoriteti mikpritës për përgatitjet e Konferencës së radhës që do të zhvillohet në Berlin, Gjermani, në qershor 2025, si dhe diskutimi mbi thirrjet për presidencën e re të ICIC dhe autoritetin mikpritës për vitin 2027.

Gjithashtu, anëtarët e Komitetit shqyrtuan aplikimin e një autoriteti për t'iu bashkuar ICIC, si dhe diskutuan mbi çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me funksionimin e kësaj organizate ndërkombëtar. Zyra e Komisionerit mbetet e angazhuar në përmbushjen e detyrave të saj si Presidencë dhe Sekretariat i ICIC, duke ndjekur me përgjegjësi të gjitha proceset dhe aktivitetet e këtij forumi të rëndësishëm botëror në promovimin e kulturës së transparencës së autoriteteve publike.



Vizitë e Ambasadorit të Britanisë së Madhe Nicholas Abbott në Zyrën e Komisionerit



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, priti në një takim zyrtar Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe në Tiranë, z. Nicholas Abbott.

Në këtë takim u diskutua mbi progresin e bërë nga Shqipëria gjatë viteve të fundit dhe në veçanti, sa i përket fushave të veprimtarisë të Zyrës së Komisionerit: e drejta për informim, mbrojtja e të dhënave personale, si dhe të dhënat e hapura. Komisioneri Dervishi i shprehu mirënjohjen Ambasadorit Abbott për mbështetjen e vazhdueshme dhe marrëdhënien e shkëlqyer të ndërtuar ndër vite me Britaninë.

Z. Dervishi e prezantoi Ambasadorin me rolin e tij si Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për të cilin tha se ndjehet i privilegjuar që drejton prej vitesh këtë institucion. Komisioneri theksoi se është përpjekur të japë kontributin e tij maksimal për të ngritur nivelin profesional të institucionit, si edhe për të forcuar marrëdhëniet me partnerët dhe institucionet homologe.

Ambasadori u njoh me veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit, funksionet, si edhe iniciativat ligjore të ndërmarra përgjatë viteve të fundit. Referuar procesit zgjedhor të 11 majit, z. Dervishi e njohu ambasadorin me kontributin që Zyra e Komisionerit ka dhënë në hartimin e një sërë aktesh të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve si, aktet për sistemin PER, politikat e privatësisë, hartimin e deklaratave të konfidencialitetit, hartimin e vendimit për votuesit nga jashtë vendit, etj.

Komisioneri Dervishi theksoi gjithashtu se siguria e sistemeve është shumë e rëndësishme në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale dhe në këtë drejtim fokusi i Zyrës së Komisionerit është të parandalojë situatat e rrjedhjes së të dhënave.

Ambasadori Abbott shprehu vlerësimet e tij ndaj Shqipërisë dhe cilësive të popullit shqiptar. Z. Abbot vlerësoi punën e Zyrës së Komisionerit dhe rikonfirmoi mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar, duke ofruar ekspertizën profesionale në funksion të rritjes së mëtejshme të kapaciteteve institucionale dhe aplikimit të standardeve më të mira ndërkombëtare.



Pyetësor lidhur me të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” është institucioni përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e së drejtës për ripërdorimin e dokumenteve, si dhe për shqyrtimin e ankesave për mosrespektimin e këtij ligji.

Në zbatim të kësaj kompetence, Zyra e Komisionerit monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e ligjit për të dhënat e hapura nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, si dhe bashkëpunimi me to përbën një nga aspektet më të rëndësishme në drejtim të garantimit të përmbushjes së qëllimit të ligjit ([Shkarko pyetësorin](#)).

Me qëllim ndërgjegjësimin e organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike por edhe të mbledhjes së të dhënave dhe krijimit të statistikave, Zyra e Komisionerit ka hartuar një pyetësor mbi zbatimin e ligjit nr. 33/2022, nëpërmjet të cilit organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike do të kuptojnë edhe detyrimet që ato duhet të përmbushin në zbatim të këtij ligji.



Ditët e të Dhënave të Hapura të Bashkimit Evropian

Ditët e të Dhënave të Hapura të BE 2025 mbledhën bashkë, për herë të parë në një format të tillë, ofrues të të dhënave, analistë, politikëbërës, akademikë, etj nga mbarë kontinenti dhe më gjerë.

Aktiviteti 2-ditor i mbajtur në data 19-20 mars 2025 në Qendrën Evropiane të Konventave në Luksemburg (ECCL), i transmetuar edhe në internet, u organizuar nga Zyra e Publikimeve dhe ekipi që administron portalin zyrtar të të dhënave të hapura të BE (data.europa.eu). Kjo ngjarje tregoi se si të dhënat e hapura po transformojnë transparencën, inovacionin, politikëbërjen dhe shoqërinë në tërësi.

Ditët e të Dhënave të Hapura të BE 2025 shërbyen për shkëmbimin e njohurive, eksperiencave dhe praktikave më të mira për komunitetin e të dhënave të hapura. Ndër temat kryesore që u trajtuan ishin ato mbi inteligjencën artificiale (AI) dhe metadat, politikëbërjen, ripërdorimi për qëllime biznesi apo metodat/mënyrat e leximit të të dhënave. Përgjatë 2 ditëve, më shumë se 2600 pjesëmarrës, e vlerësuan këtë aktivitet për diversitetin dhe cilësinë e përmbajtjes.

Vendimmarrja e Komisionerit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë muajit m 2025 ka dhënë një vendim në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Sipas Vendimit nr. 2, datë 26.03.2025, Komisioneri ka pranuar ankesën ndaj Autoritetit Publik “Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit” (në vijim “Autoriteti Publik” ose “QKLL”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”. Ankuesi, nëpërmjet kërkesës së datës 23.12.2024, depozituar në adresën elektronike zyrtare, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni “dokumentin/dokumentet zyrtarë me të cilat është përzgjedhur/emëruar Juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2023; proces verbalin e zgjedhjes së kryetarit të Jurisë së Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2023; rregulloren e funksionimit të Jurisë së Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2023; numrin e protokollit dhe datën e secilës kontratë të nënshkruar me secilin prej anëtarëve të Jurisë së Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2023, të shoqëruar me kopjen përkatëse të secilës kontratë; kopje të proces verbalit të mbledhjes ku janë përcaktuar nga QKLL-ja dhe plotësuar nga anëtarët e jurisë kriteret mbi të cilat është ngritur puna e tyre për këto çmime; informacion dhe dokumentacion për shpalljen e konkursit letrar “Qytetet e padukshme” shpallur më 27.09.2024: Cila është Juria? Në cilën fazë është ky projekt?”

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it ka informuar kërkuuesin në lidhje me kërkesën objekt shqyrtimi, duke sqaruar konkretisht se: “Për pikën 1: Juria e Çmimeve Kombëtare e Letërsisë për vitin 2023 është ngritur bazuar në Rregulloren e Funksionimit të Çmimeve Kombëtare të Letërsisë, Kreu III, neni 5, pika 1, ku thuhet: “Juria emërohet nga drejtori i QKLL-së. Emrat e jurisë diskutohen në mbledhjen e Kolegjiumit në fillim të vitit kalendarik”. Në procesverbalin e mbledhjes së Kolegjiumit datë 23.01.2024, nr. 41 prot., anëtarët e tij kanë propozuar një listë emrash nga të cilët me Urdhër nr. 11, datë 29.01.2024 janë emëruar si anëtarë të Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2023: z. Blendi Lami, përkthyes, z. Koloreto Cukali poet, znj. Entela Kasi poete, z. Xhevat Lloshi studiues, znj. Monika Stafa gazetarë kulture. Për pikën 2: Referuar Rregullores së Çmimeve Kombëtare të Letërsisë kreu III, neni 6, pika 2 ku thuhet “Zgjedhja e kryetarit bëhet në mbledhjen e parë të jurisë”, në mbledhjen e parë të Jurisë të mbajtur më datë 19.02.2024, nr. 113 prot., është vendosur mes tyre që z. Koloreto Cukali të jetë kryetar i këtij edicioni. Porcesverbali i mbledhjes është i firmosur nga të 5 anëtarët e jurisë.

Për pikën 3: Rregullorja është bashkëlidhur. Për pikën 4: Nr. 70 prot, dt 29.01.2024, z. Xhevat Lloshi; Nr. 71 prot. dt. 29.01.2024, znj Monika Stafa; Nr. 77, prot, dt. 29.01.2024 znj Koloreto Cukali; Nr. 78, prot, dt 29.01.2024 znj. Entela Kasi; Nr. 79, prot.dt 29.01.2024 z. Blendi Lami. Referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, neni 3, pika 4, kontratat e mësipërme përmbajnë të dhëna personale të subjekteve si të tilla ato nuk mund të jenë publike. Gjithashtu, referuar ligjit të mësipërm, nenit 17, pika 4 “kërkesa është e paqartë”. Për pikën 5: Procesverbalet nuk mund të bëhen publike për sa kohë, konkursi është në proces, pasi përmbajnë informacione kofidenciale mbi diskutimet e veprave, autorëve konkurues, qëndrime të ndryshme të anëtarëve mbi veprat në gjykim. Kriteret janë detyrë e jurisë. Deri tani pranë QKLL, janë depozituar 5 procesverbale të firmosura nga të 5 anëtarët e jurisë. Referuar Rregullores së funksionimit të jurisë nenit 8, pika 3, ku thuhet “Juria, pas përfundimit të çdo faze shqyrtimi dhe vlerësimit të veprimtarisë artistike dhe kulturore, dorëzon dokumentacionin në zyrën e protokoll/Arkiv të Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, procesverbalet e mbledhjeve të jurisë janë protokolluar me numrat si më poshtë: Mbledhja I Nr. 113 Prot., dt.19.02.2024; Mbledhja II Nr. 570 Prot., dt.09.09.2024; Mbledhja III Nr.570/1 Prot., dt. 25.09.2024; Mbledhja IV Nr. 695 Prot., dt 21.11.2024, Mbledhja V Nr. 740 Prot., dt 17.12.2024. Për pikën 6: Në kuadër të aktiviteteve me rastin e 80-të vjetorit të Çlirimit të vendit, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit konceptoi disa ide aktivitete për t’i realizuar përgjatë këtij viti të rëndësishëm historik, si konferenca, ekspozitë me vizatime të dëshmorëve të luftës, promovime dhe konkursin drejtuar autorëve shqiptarë “Qytetet e padukshme”... Në këto kushte, referuar Rregullores, por dhe procedurave të funksionimit të projekteve të tilla nuk ka patur asnjë juri të emëruar për këtë konkurs dhe asnjë fond të brendshëm të elakuuar për këtë projekt.”

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesi me e-mail i është drejtuar edhe njëherë QKLL duke sqaruar se mungon dokumentacioni i kërkuar. Në mungesë të një përgjigje, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për dhënien e dokumentacionit të kërkuar në pikën 1, 2, 3, 4 dhe 5 të kërkesës për informacion.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të LDI. Në ndjekje të procedurës, Zyra e Komisioneri kërkoi nga Autoriteti

Publik, sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe argumentimin përkatës në rast të kufizimit të së drejtës për informim, bazuar në nenin 17 të LDI. Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “...dokumentet që kërkon, në bazë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 17 “Kufizimi i së drejtës për informim”, pika 2, germa dh) barazia e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit nuk mund të vërë në dispozicion asnjë prej dokumenteve të sipër kërkuara, pasi institucioni ynë është në proces gjyqësor me ish-punonjësën e saj, që nga data 16.05.2023 e në vazhdim.”

Në vijim të procedurës, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, Komisioneri ftoi autoritetin publik në një seancë dëgjimore, me prezencën e koordinatorit për të drejtën e informimit të këtij të fundit. Gjatë saj, koordinatori rikonfirmoi qëndrimin e mbajtur nga QKLL në shkresat drejtuar Zyrës së Komisionerit. Ndërkohë, kjo e fundit parashitroi se nga përgjigja e Autoriteti Publik mbeten të paqarta ende dy momente, konkretisht, ekzistenca e një procesi gjyqësor dhe nëse dokumentacioni i kërkuar cenon barazinë e palëve në një proces gjyqësor. Pra, nëse ky dokumentacion është apo jo pjesë e procesit gjyqësor dhe nuk mund t'i nënshtrohet shqyrtimit administrativ. Në pamundësi për t'i sqaruar këto paqartësi në seancë, i'u la detyrë koordinatorit që brenda një periudhe të caktuar të provonte ekzistencën e procesit gjyqësor, si dhe lidhjen e këtij procesi me secilën nga dokumentat e kërkuara në kërkesën fillestare për informacion të ankuesit.

Koordinatori për të drejtën e informimit të QKLL, nëpërmjet e-mail-it sqaron se “info” e institucionit është hakeruar, ndërsa përgjigja është nisur që në datën 06.03.2025. Konkretisht, në përgjigjen bashkëlidhur këtij e-mail-i, Autoriteti Publik ka vendosur në dispozicion të ankuesit edhe njëherë informacionin si të dërguar me shkresën nr. 751 prot., datë 24.12.2024, duke sqaruar gjithashtu se: “...Lidhur me kërkesat mbi akses në procesverbalet dhe punën e jurisë, i kujtojmë LDI, nenin 3, pika 4 ku thuhet se: “me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji”. Referuar fyerjeve dhe gjuhës jashtë etikës që ankuesi ka referuar në postimet e tij publike kundrejt jurisë së këtij Konkursi të rëndësishëm dhe Qendrës e drejtueses së saj, duke dëmtuar imazhin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit dhe të Jurisë, i kujtojmë sërish LDI, neni 17.”

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar, nëpërmjet e-mail ka kërkuar vijimin e procedurës së ankimit pranë Komisionerit.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë shqyrtimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI. Në kuptim të parashikimeve të tij QKLL, si autoritet publik, detyrohet ta zbatojë atë, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës, ndërsa, përgjegjësia për tjetërsimin e informacioneve bie mbi individin që merr apo përdor këtë informacion.

Pretendimi për kufizimin e informacionit publik për shkak të një dëmi të ardhshëm, të mundshëm, si pasojë e keqpërdorimit të informacionit publik, nuk përbën bazë ligjore për kufizim. Në rast keqpërdorimi të informacionit publik nga ana e kërkuar, Autoriteti Publik ka në dispozicion instrumentet ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të shkelura. Autoriteti Publik nuk arriti në asnjë moment të provonte ekzistencën e procesit gjyqësor, si dhe lidhjen e këtij procesi me dokumentat objekt shqyrtimi, të cilat, për rrjedhojë mund edhe të cenonin barazinë e palëve në procesin gjyqësor. Gjithashtu, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Në përfundim, u vendos pranimi i ankesës dhe urdhërimi i autoritetit publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës fillestare (cituar më sipër) duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



KONSULTONI FAQEN WWW.IDP.AL PËR T'U NJOHUR ME TË REJAT
MË TË FUNDIT TË ZYRËS SË KOMISIONERIT
RRUGA ABDI TOPTANI, ND. 5, KODI POSTAR 1001, TIRANË
INFO@IDP.AL / +35542237200